


DREJTËSIA NË DEMOKRACI



PJESË E DEMOKRACISË JEMI NE FËMIJËT

ART (11), URIM (11), DORIT (11), ERIJONA (11), TRËNDELINË (11), ONAR (10), ORGESA (11),

ARXHIRA (11)



Të gjithë ju që keni ndarë pak nga koha juaj e çmuar për të lexuar gazetën tonë, ne iu themi që nga artikulli ynë dhe nga artikujt e dy grupeve të tjera, do të befasoneni nga informatat e shumta që do t'i merrni. Shkruarja e kësaj gazete është një ndër veprimet më të zgjuara që kemi bërë kohëve të fundit

Liria, barazia, respekti, toleranca, solidariteti, shprehja e lirë e mendimit, etj., janë disa nga elementet kryesore të demokracisë. Për ne, si shoqëri demokratike që të gjitha këto elemente kanë rolin dhe rëndësinë e tyre. Është pothuajse e pamundur që të përipiqemi t'i ndajmë apo që t'i japim rëndësi më të madhe ndonjërit prej këtyre elementeve.

Në filltet e para të demokracisë nuk kanë qenë të zbatuara të gjitha këto elemente që i përmendëm më lartë dhe njerëzit kanë qenë të diskriminuar. Ajo që ka qenë më së shumti e theksuar ishte pabarazia. Kishte dallime shumë të mëdha mes gjinive, shtresave ekonomike, e ndonjëherë edhe mes moshave. Si do të ndjesheshim ne po që se në zgjedhjet e përgjithshme ose lokale të mos kenë të drejtë të votojnë gjyshërit tanë për shkak të moshës së tyre? Për ne si gjeneratë që gëzojmë demokracinë, ky fakt është i papranueshëm. Në asnjë mënyrë nuk do të lejonim që ky diskriminim i këtij lloji të ndodhë prapë, siç ka qenë i pranishëm në filltet e para të demokracisë. Ne e dijmë se kur njëherë fitohet e drejta e votës, ajo nuk ka afat të limituar.

Edhe pse kanë kaluar shumë kohë që prej shfaqjes së demokracisë, ende në botë ka shtete të cilat nuk e gëzojnë këtë sistem. Por, a e dini ju se kur dhe ku lindi

demokracia?

Demokracia për herë të parë është paraqitur në kryeqytetin e Greqisë, në vitin 507 p.e.s. Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja e vjetër, „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje. Pra, fjala e popullit është e para dhe kryesorja. Në këtë mënyrë funksionon edhe vendi ynë. Populli me anë të votës së lirë i zgjedh përfaqësuesit të cilët e udhëheqin vendin. Ne, të dashur lexues po e përfundojmë me kaq për demokracinë. Duhet të jemi krenarë që jetojmë në vendin tonë të dashur dhe demokratik, Kosovën. Shpresojmë se do të merrni ndonjë informatë nga ky artikull.



Ne jemi e ardhmja e vendit tonë!

LIGJET E MIRATUARA NGA DEPUTETËT

ERDI (10), ELDA (11), ENES (11), FITON (11), OLTİ (10), DIANA (11), LINERA (10), SUELA (11)



Fakte rreth Kuvendit të Kosovës, institucionit të vetëm legjislativ

Barazia dhe liria janë fjalë të cilat përmenden shumë shpesh në demokraci. Në demokraci, të gjithë jemi të barabartë. Të drejtat tona i kemi të garantuara me ligj. Se ku merren vendimet për këto ligje, mund ta kuptoni në vazhdim.

Ishte ditë e enjte, vendin e kishte kapluar acari i ftohtë i dimrit. Albini dhe Erleta, motër e vëlla, ishin duke shikuar televizorin dhe aty po shihnin Kuvendin e Kosovës, ku po mbahej një seancë plenare nga deputetët. Duke parë Kuvendin, atyre iu shtua kureshtja më shumë dhe dëshironin të dinin gjëra të ndryshme për Kuvendin. Kështu, vendosën që të shkonin një ditë dhe ta vizitonin këtë institucion. Më 17 shkurt, në Ditën e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Albinit dhe Erletës iu plotësua dëshira, sepse patën mundësi që të shkonin ta vizitonin Kuvendin. Kur shkuan atje mësu- an shumë gjëra: që Kuvendi ka 120 deputetë, që ligjet janë rregulla që duhen të respektohen, për funksionet që i ka Kuvendi (funksioni legjislativ, kontrollues dhe ai përfaqësues), etj. Albini dhe Erleta kaluan shumë mirë dhe në mendjet e tyre, mbetën disa fjalë që iu tregoi njëri nga zyrtarët e Kuvendit: „Zgjedhjet e liria janë themeli i një shoqërie demokratike. Pra, në demokraci të gjithë janë të barabartë dhe i gjithë populli ka të drejtën e vendimmarrjes.“

Kur u kthyen në shtëpi, ata i thirrën shokët e tyre dhe



Në demokraci, të gjithë e kemi të drejtën e shkollimit. Këtë të drejtë e kemi të garantuar me ligj


iu treguan se çfarë kishin mësuar për Kuvendin e Kosovës. Të dashur lexues, ne kemi një mesazh për ju: „Dëshira jonë është që të gjithë ne të jemi sa më të përgjegjshëm dhe t'i respektojmë e t'i zbatojmë ligjet. Le të bëhemi qytetarë të përgjegjshëm!“



Grupi „Toka“

ZGJEDHJET DHE MEDIA

JON (11), ELSA (11), ANDI (10), LEA (10), SHPAT (10), AURITA (11), ALOR (11), ORGES (10)



Në demokraci, çdo individ ka të drejtën të zgjedh. Disa votojnë dhe zgjedhin për çështje më të vogla, e disa për çështje më të mëdha. E kjo dallon nga mosha e qytetarëve

Ne si nxënës të klasës së pestë, që nga klasa e parë e kemi bërë si traditë që çdo muaj të votojmë për nxënësin/en e muajit. Këta nxënës, ne i votojmë në bazë të disa kriterëve, të cilat janë: sjelljet e tyre, sa kanë qenë aktiv gjatë orëve mësimore, etj.

Zgjedhjen e nxënësit/es të muajit, ne e bëjmë me votim të hapur. Secili prej nesh i/e cili/a mendon se duhet të votojmë për nxënësen apo nxënësin e caktuar, e ngrisim dorën dhe ajo është shenjë se ne votojmë pro atij personi.

Ne bëjmë edhe zgjedhje të tjera në klasën tonë, e që është zgjedhja e kryetarit/es së klasës. Zgjedhjen e tij/saj, e bëjmë me votim të mbyllur.

Funksioni i kryetarit/es të klasës është shumë i rëndësishëm, sepse në rastet kur mësuesja nuk është në klasë, atëherë ai apo ajo duhet ta zëvendësojë mësuesen. Këtë e bën vetëm për të ndihmuar në menaxhimin e qetësisë së klasës kur mësuesja mungon.

Zgjedhje të cilat i kemi cekur më lart, janë zgjedhje të cilat nuk kërkojnë moshë të caktuar për të votuar, sepse edhe nën moshën 18 vjeçare, mund ta kryejmë një veprim të tillë.

Por, kur të arrijmë moshën 18 vjeçare, ne mund të

dalim dhe të votojmë edhe në zgjedhje më të rëndësishme, siç janë zgjedhjet lokale dhe ato qendrore. Në zgjedhjet lokale, zgjedhen kryetarët e komunave dhe asamblistët. Kryetari i komunës duhet t'i përfaqësojë kërkesat e qytetarëve të komunës të cilën e përfaqëson. Në zgjedhjet qendrore, zgjedhen deputetët e Kuvendit, të cilët janë përgjegjës për të gjithë qytetarët e shtetit. Shpresojmë se shembulli ynë për zgjedhjet që ne i bëjmë në klasë, iu ka ndihmuar që ta kuptoni edhe më mirë procesin zgjedhor, si atë lokal ashtu edhe atë qendror.



Zgjedhja jonë për sot është të jemi gazetarë

Për të mësuar më shumë se si zgjedhjet kanë ndikim në jetën tonë, më poshtë mund të lexoni më shumë për atë se si na ndihmon media që ne të dijmë çdo gjë që neve na intereson, e sidomos për procesin zgjedhor

Në artikullin paraprak, patët mundësi të lexoni për zgjedhjet në jetën e përditshme, dhe për zgjedhjet shtetërore.


I gjithë procesi zgjedhor është shumë i rëndësishëm për qytetarët. Ne kemi nevojë të informohemi më shumë se çfarë po ndodh me votat e personave të cilët kanë votuar. Secili nga kandidatët për kryetarë komune, apo kandidatët për deputetë apo asamblistët komunal, kanë për qëllim ti bindin qytetarët se ata janë

personat e duhur për atë pozitë. E programin e asaj se çka planifikojnë të bëjnë në të ardhmen, ne mund ta shohim përmes medias.

Media ndahet në të shkruar dhe atë elektronike. Në median e shkruar hyjnë: gazetat, revistat, romanet, etj. Ndërsa, në median elektronike hyjnë: interneti, kompjuteri, televizioni, etj. Media është shumë e rëndësishme, sepse ajo na mban të informuar për çdo gjë që ndodh si brenda apo jashtë shtetit.



Ne mund të marrim pjesë në procesin zgjedhor që nga moshën 18 vjeçare



Në këtë vizatim kemi paraqitur median e shkruar, e cila na informon për çdo gjë



Televizioni dhe kompjuteri hyjnë në median elektronike



Deputetët janë përfaqësuesit tanë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Sadulla Brestovci“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjilan